

QYTETI I SHKUPIT

Në pajtim me Programin për subvencionimin e qytetarëve për blerjen e inverterëve me efikasitet të lartë për ngrohje, për vitin 2020 („Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit “ nr.1/20), Qyteti i Shkupit shpall

THIRRJE PUBLIKE

për subvencionimin e qytetarëve për blerjen e inverterëve – kondicionerëve me efikasitet të lartë për ngrohje për vitin 2020

1. Përshkrimi i Thirrjes publike

- 1.1. Qyteti i Shkupit, me qëllim stimulimin e banorëve të qytetit të Shkupit (amvisëritë) për përdorimin e inverterëve – kondicionerëve me efikasitet të lartë për ngrohje në shtëpitë e tyre, të cilat janë më ekonomike, më efikase nga ana energjetike dhe të pranueshme nga aspekti ekologjik, qytetarëve që kanë blerë pajisje inverterë – kondicionerë me efikasitet të lartë gjatë vitit 2020 do t'u kompensojë një pjesë të shpenzimeve të gjeneruara gjatë blerjes së pajisjes, jo më shumë se 62.000,00 denarë në shumën neto për amvisëri. Pagesa e mjeteve do të realizohet pas përfundimit të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2020. Tatimi personal do të bie në barrë të Qytetit të Shkupit.
- 1.2. Thirrja publike do të zgjasë deri më 30 nëntor 2020 ose deri në përfundimin e mjeteve financiare të parapara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për këtë qëllim, në varësi prej asaj se cili kusht do të shfaqet i pari.
- 1.3. Në rast të përfundimit të të gjitha mjeteve financiare të parapara me Buxhetin e Qytetit të Shkupit për këtë qëllim, Qyteti i Shkupit do ta informojë opinionin në ueb-faqen e tij se Thirrja publike është ndërprerë para skadimit të afatit për të cilin është shpallur thirrja.
- 1.4. Thirrja publike do të realizohet sipas parimit „i pari i paraqitur i pari i shërbyer“.

2. E drejta për pjesëmarrje në Thirrjen publike:

- 2.1 Të drejtën për pjesëmarrje në Thirrjen publike e kanë banorët e qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Gazi Babë, Kisella Voda, Karposh, Çair, Shuto Orizare, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj) të cilët kanë blerë inverterë – kondicionerë me efikasitet të lartë për ngrohjen e amvisërive të tyre (objekte të banimit) në periudhën nga 01.01.2020 deri në mbarimin e Thirrjes publike dhe do të cilët do të parashtrojnë kërkesën për kompensimin e shpenzimeve.
- 2.2 Në Thirrjen publike nuk kanë të drejtën e pjesëmarrjes banorët (amvisëritë) të cilët posedojnë objekte banimi që janë kyçur në ngrohjen qendrore të qytetit pa marrë parasysh nëse atë e shfrytëzojnë apo jo, amvisëritë që kanë mundësi teknike për kyçje në sistemin për ngrohje qendrore si dhe banorët (amvisëritë) të cilët posedojnë objekt banimi në fazën e ndërtimit dhe të cilët nuk jetojnë në të njëjtin.

3. Kushtet të cilat duhet ti plotësojë kërkuesi:

- 3.1. Kërkuesi duhet ti plotësojë kushtet e mëposhtme:
 - të jeton në vendbanimin që gjendet në territorin e qytetit të Shkupit (komunat: Aerodrom, Gazi Babë, Kisella Voda, Karposh, Çair, Shto Orizare, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj),
 - të mos ketë shfrytëzuar subvencione për ngrohje (koftorë me peleta / inverter) në shtëpitë e tyre (objekte të banimit) nga Qyteti i Shkupit,
 - deri në çastin e parashtrimit të kërkesës të shfrytëzojnë koftor me qymyr, dru, naftë ose mazut,
 - t'ia dorëzojë Qytetit të Shkupit ose shërbimeve të ndërmarrjeve publike të Qytetit të Shkupit, koftorin të cilin e shfrytëzon i cili shpenzon qymyr, dru, naftë ose mazut. Lokalitetet dhe koha

- për dorëzimin e koftorëve të vjetër do të përcaktohen në mënyrë plotësuese dhe për këtë qytetarët do të jenë të informuar në faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk;
- pajisja të jetë blerë në vitin 2020 deri në përfundimin e Thirrjes publike, dhe e njëjta të jetë e paguar tërësisht dhe të jetë e instaluar në adresën e banimit të theksuar në letërnjoftimin e kërkuarit,
- pajisja e blerë, detyrimisht të posedoj së paku karakteristikat vijuese: të posedoj së paku SOR 3.5, të ngrohë në temperaturën e jashtme prej -15°C dhe të jetë së paku i klasit energjetik A+, për shpenzimin e energjisë elektrike për ngrohje;
- objekti i banimit të mos jetë në fazën e ndërtimit dhe kërkuari të jetojë në të,
- të mos ekzistojë kyçja në ngrohjen qendrore në suaza të objektit banesor ku do të instalohet pajisja, pa marrë parasysh faktin se vallë e shfrytëzon të njëjtën, dhe
- të mos ketë mundësi teknike për kyçje në sistemin për ngrohje qendrore.

3.2 Për kërkuarit të cilët nuk posedojnë objekte të reja të ndërtuara të banimit, dhe të cilët nuk posedojnë kurrfarë ngrohje dhe të cilët nuk janë të kyçur në ngrohjen qendrore, nuk vlejnë kushtet e theksuara në pikat 3, nën pikën 3.1 alineja 3 dhe 4.

3.3 Vetëm një person për një amvisëri (objekt banimi) mund të parashtrojë një kërkesë për fitimin e kompensimit gjatë kësaj kërkesa mund të përfshijë një apo më shumë pajisje, por kërkuari duhet patjetër t'i plotësojë kushtet e kësaj thirrjeje publike për të gjitha pajisjet, të dorëzojë aq koftorë sa pajisje do të furnizoj dhe kompensimi i shpenzimeve të bëra për furnizimin e të gjitha pajisjeve nuk do ta tejkaloj shumën prej 62.000,00 denarë në neto vlerë.

Vërejtje: Kërkuari patjetër duhet t'i përmbush të gjitha kushtet e lartpërmendura që kërkesa e tij të pranohet. Në të kundërtën Komisioni do të dorëzoj propozimin deri te Kryetari i Qytetit të Shkupit për mos pranimin e kërkesës.

4. Mënyra e aplikimit në Thirrjen publike

4.1. Për kompensimin e një pjese të shpenzimeve dhe për të dëshmuar se kriteret për pjesëmarrje janë përmbushur, kërkuari deri te Qyteti i Shkupit duhet ti dorëzojë këto dokumente:

- kërkesë të nënshkruar dhe e skanuar për kompensim (Kërkesa mund të merret prej faqes zyrtare të Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);
- skanimin e letërnjoftimit me afat të vlefshëm, si dëshmi se i njëjti është banorë i qytetit të Shkupit;
- fotografi të skanuar të koftorit me dru, qymyr, naftë ose mazut, të cilin e shfrytëzon;
- deklaratën e noterizuar dhe të skanuar me të cilën konfirmon se me vetë dëshirë dhe pa kompensim do t'ia dorëzojë koftorin të cilin e shfrytëzon i cili ngroh me qymyr, dru, naftë ose mazut Qytetit të Shkupit ose shërbimeve të ndërmarrjeve publike të Qytetit të Shkupit dhe se nuk ka shfrytëzuar subvencione për ngrohje (koftorë me peleta / inverterë) në amvisërinë e tij (objektin e banimit) të fituara nga Qyteti i Shkupit (shembulli i deklaratës do të shpallet në faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);
- vërtetim origjinal të skanuar dhe të vërtetuar me nënshkrim dhe vulë nga shitësi, që kondicioneri – inverteri i furnizuar është me efikasitet të lartë, përkatësisht se i plotëson karakteristikat minimale vijuese: të posedoj së paku SOR 3.5, të ngrohë në temperaturën e jashtme prej -15°C dhe se i

përket së paku klasës energjetike A+, për shpenzimin e energjisë elektrike për ngrohje (shembulli i vërtetimit do të shpallet në faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);

- dëshmi origjinale të skanuar se është realizuar blerja gjatë vitit 2020, edhe atë vetëm me një llogari fiskale ose me faturën me certifikatë nga bankë afariste, si dëshmi për realizimin e pagesës së tërësishme, dhe

- llogari të skanuar të transaksionit.

4.2. Kërkuesit të cilët posedojnë objekte të reja të ndërtuara, dhe të cilët nuk posedojnë kurrfarë ngrohje dhe të cilët nuk janë të kyçur në ngrohjen qendrore të qytetit, nuk duhet ti parashtrojnë dokumentet e parapara në pikën 4, nën pikën 4.1 alineja 3 dhe 4.

4.3. Parashtruesi kërkesën dhe dokumentacionin shtesë duhet t'i bashkëngjisë të skanuar në platformën për aplikime on – line, të shpallur në faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk);

4.4 Kërkesat e parashtruara me dokumentacionin përcjellës në platformën për aplikime on – line të shpallur në faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk) do të evidentohen me orën e saktë të parashtrimit (datën, orën dhe minutat), me qëllim të përcaktimit të radhitjes sipas cilës do të shqyrtohen kërkesat.

4.5 Në raste të parashtrimit të dokumentacionit të pa rregullt dhe të pa kompletuar, Komisioni do t'i refuzojë kërkesat si të pakompletuara menjëherë pas shqyrtimit të tyre dhe do ti njofton kërkuesit në mënyrë elektronike. Kërkuesit gëzojnë të drejtën që përsëri të dorëzojnë kërkesën deri sa zgjat thirrja publike.

Vërejtje: Kërkuesi patjetër duhet të dorëzojë dokumentacion të kompletuar si shtojcë të kërkesës në pajtim me pikën 4. Në të kundërtën, kërkesa do të refuzohet.

5. Mënyra e realizimit të Thirrjes publike

5.1. Kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komisionin për zbatimin e Thirrjes publike, i cili do ta realizojë procedurën në tre faza:

- Në fazën e parë, do t'i shqyrtojë kërkesat e parashtruara dhe dokumentacionin e dhënë si shtojcë, me qëllim të përcaktoj se vallë të njëjtit janë të rregullta dhe të kompletuara;

- Në fazën e dytë, Komisioni do të kryejë kontrollin e detajuar të dokumentacionit të parashtruar, nga pika 4 me qëllim të përcaktimit se vallë i njëjti i përmbush kushtet nga pika 3 të kësaj Thirrje publike, dhe

- Në fazën e tretë, do të kryej kontrollimin e vërtetimeve për dorëzimin koftorëve të vjetër dhe të njëjtit do t'ia bashkëngjit dokumentacionit të dorëzuar nga pika 4.

5.2. Komisioni mban të drejtën e kontrollit në terren tek të gjithë kërkuesit të cilët kanë parashtruar dokumentacionet e rregullta dhe të kompletuara, që të konfirmoj se vallë të njëjtit i kanë përmbushur kushtet e parapara me këtë Thirrje publike. Kërkuesi është i detyruar që ti mundësoj qasje Komisionit deri te objekti i banimit dhe deri te hapësira ku është instaluar kondicioneri – inverteri i furnizuar me efikasitet të lartë.

5.3. Për kërkesat e dorëzuara dhe të shqyrtuara nga pika 5, nën pika 5.1 alineja 1, do të drejtohet lista me të dhënat vijuese:

- emri, mbiemri dhe adresa,
- data dhe ora e dorëzimit të fletëparaqitjes për Thirrjen publike, dhe
- shuma e kompensimit për kërkuesin.

5.4. Pagesa e mjeteve të lejuara do të kryhet në mënyrë sukcesive, sipas radhës së kërkesave të dorëzuara, sipas parimit „i pari i paraqitur, i pari i shërbyer”, pas miratimit të aktvendimeve për miratimin e kërkesave nga ana e Kryetarit të Qytetit të Shkupit, dhe

5.5. Pas përfundimit të procedurës së tërësishme, kërkuesi duhet ti mundësojë qasje Komisionit deri te objekti i banimit dhe deri te hapësira në të cilën është instaluar pajisja edhe gjatë 2 viteve të ardhme, pas përfundimit të Thirrjes publike.

6. Mënyra e realizimit të së drejtës së kompensimit

6.1. Kryetari i Qytetit të Shkupit në propozim të Komisionit do të miratoj aktvendim për miratimin e kërkesës për kërkuesit të cilët i kanë plotësuar kushtet e kësaj Thirrjeje publike, dhe në rast të mos pranimit të kërkesës, në propozim të Komisionit, Kryetari i Qytetit të Shkupit dorëzon njoftimin me shkrim për mos pranimin e kërkesës.

Nr. _____
Viti _____
SHKUP